



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Zyra e Personelit

Nr. 111-5478/18

Klinë, 15/08/2018

Duke u bazuar në Ligjin e Sherbimit Civil të Kosovës nr. 03/L-149 nenin 11 të këtij Ligji, dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Sherbimin Civil të Republikës së Kosovës, Udhëheqesi i Personelit bën:

SHPALLJEN E REKRUTIMIT
Zyrtar për Trashëgimi (1 Ekzekutues)

Mbikëqyrësi:
Koeficienti I pagës:

Drejtori i Drejtorisë për Kulturë Rini e Sport, Komuna Klinë
6

Orari i punës:
Vendi:
Kohëzgjatja e Emrimit:

i plotë
Klinë
Sipas Ligjit të sherbimit civil-karrierës

Numri i referencës:

JP00034076

Qëllimi dhe rezultatet:

Organizimi dhe zhvillimi i aktiviteteve në punët e trashëgimis kulturore.

Detyrat dhe përgjegjësit e detyrave punuese:

- Udhëheqje me punët e Zyres për Trashëgimi Kulturore në Komunen e Klinës,
- Harton planin për trashëgimi kulturore;
- Bënë hulumtimin dhe identifikimin e vlerave të trashëgimisë kulturore;
- Bënë regjistrin për objektet- vlerat e trashëgimisë kulturore;-
- Kujdeset në ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore në nivel Komunal;
- Organizon ekspozita për promovim të vlerave trashëgimisë;
- Bënë përgatitjen e buletinit për monumente dhe vlerat tjera të trashëgimisë;
- Bënë hulumtimin e vendeve dhe trevave arkeologjike, harton planet për to dhe merr pjesë në udhëheqjen e gërmimeve arkeologjike,
- Bashkëpunon dhe koordinon punët e zyrës me strukturat tjera në nivel vendi me Institutin Arkeologjik të Kosovës, pastaj Muzeun e Kosovës dhe me Institutin për Mbrojtjen e monumeteve të kultures;
- Përfaqëson komunën në ekspozita- seminare në nivel vendi dhe jashtë në aspektin e trashëgimisë kulturore;-
- Kryen edhe punë të tjera sipas ligjit, urdhrit dhe kërkesës së eprorit, të cilit edhe i përgjigjet.

Shkathësitë tjera të kërkuara:

- Aftësi në organizim të punëve të zyrës
- Aftësi në përdorim të kompjuterit dhe programeve përkatëse
- Gatishmëri dhe aftësi për të punuar në ekip

Shkollimi i kërkuar: Diploma Univerzitare – Fakulteti: I Historis ose I Etnologjisë,

Kualifikimi: DU+2 vite pervojë

Mënyra e Aplikimit:

Formularët për Aplikim mund të merren në **Zyrën Komunale të Personelit në katin e tretë** ku edhe është bërë shpallja e rekrutimit dhe dorëzohen po në të njëjtën zyrë. Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni në Zyrën e Personelit, përmes telefonit fiks 039 471 550, 84 722 ose telefonit mobil 044/887659.

Shpallja, mbetet e hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik. Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk pranohen.

Ligji i Sherbimit Civil ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femrore si dhe nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

